

**VENDIM**  
**Nr. 519, datë 20.9.2017**

**PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT<sup>1</sup>**

*(Ndryshuar me VKM nr.738, datë 13.12.2017)*

*(I përditësuar)*

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Këshilli Kombëtar i Territorit, si autoritet kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- |   |         |
|---|---------|
| - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë | anëtar; |
| - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë       | anëtar; |
| - Ministrin e Drejtësisë                    | anëtar; |
| - Ministrin e Kulturës                      | anëtar; |

- Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

anëtar;

- Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit

anëtar;

- Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

anëtar;

- Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit

anëtar dhe sekretar.

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri apo ministri anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, përkatësisht, me të drejtë vote:

- personi i autorizuar nga Kryeministri, i cili kryeson mbledhjen;
- zëvendësministri, përfaqësues i ministrit në mungesë.

3. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Territorit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

5. Brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga dita e zhvillimit të mbledhjes, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) shpërndan vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të KKT-së, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar.

6. Vendimi nr. 1097, datë 28.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**

<sup>1</sup> VKM nr.519 datë 20.9.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.171, 26 shtator.  
VKM nr.738 datë 13.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 225, 22 dhjetor 2017.